

FTESE PER OFERTE

I/E nderuar Zotëri/Zonje,

1. Ju jeni te lutur te paraqitni ofertën tuaj për **“Vleresim i konformitetit te Instalimeve Elektrike dhe shërbimeve te tjera te lidhura me te, ne ambientet ku zhvillohet aktiviteti bankar”** për nevoja te Tirana Bank.
*Për informacion me te detajuar ju lutem shikoni **Aneksat A dhe B** bashkëngjitur.*

2. Ju mund te jepni ofertën Tuaj për shërbimin e lartpërmendur, për te cilat do te ketë procedure vlerësimi dhe do te lidhet kontrate me ofertuesin/ofertuesit me te mire. {Ju mund te paraqisni ofertën tuaj duke u bazuar ne FTESEN PER OFERTE}.

3. Oferta Juaj duhet te dërgohet ne zarf te mbyllur. Sipër zarfit duhet te shënoni emrin e kompanisë dhe titullin e tenderit **“Vleresim i konformitetit te Instalimeve Elektrike dhe shërbimeve te tjera te lidhura me te, ne ambientet ku zhvillohet aktiviteti bankar”** dhe ta dërgoni ne adresën:
Njësia e Prokurimit
Tirana Bank, Zyrat Qendrore
Bulevardi “Zhan D’Ark”, Njesia Administrative nr. 2, Godina “MET Tirana Building”,
Tirane

4. **Afati i fundit i pranimit te ofertave** është:
29.05.2026

5. **Detajet:**
 - **Ky tender përfshin “Vleresim i konformitetit te Instalimeve Elektrike dhe shërbimeve te tjera te lidhura me te, ne ambientet ku zhvillohet aktiviteti bankar” si me poshtë:**
 - a. Certifikim i Instalimeve Elektrike ne ambientet ku zhvillohet aktiviteti bankar, Degët e Rrjetit dhe Godina e Zyrove Qendrore (Sipas Aneksit A bashkëlidhur),
 - b. Inspektim dhe certifikim i Ashensorëve:
Ne mënyre te detajuar, te gjithë zërat jepen ne Aneksin A bashkëngjitur.

6. **Çmimet**

Ju do te paraqisni ofertën tuaj financiare (sipas Aneksit A) si me poshtë:

 - A) Certifikimi i instalimeve elektrike per Zyrat qendrore dhe degët e Tirana Bank qe do te kryhet një here ne vit.
 - B) Inspektim/Certifikim I kabinës se transformimit TM/TU 20/0.5 KV (Shkodër dhe Korçë) qe do te kryhet një here ne 3 vjet.
 - C) Certifikim periodik 6 mujor për Ashensori.
 - Ne çmim duhet te përfshihet TVSH, transport dhe çdo takse dhe shpenzim tjetër.
 - Çmimet do te mbeten te panyshuara gjate gjithë kohëzgjatjes se kontratës.
 - Ju duhet te paraqitni Termat e pagesës ne lidhje me termat e kryerjes se shërbimit. Kushtet standarde të pagesës për Tirana Bank janë 30 ditë pas ofrimit të shërbimit dhe lëshimit të faturës. Pranuar nga ju _____

Përshkrim i detajuar jepet ne aneksin A, ku duhen plotësuar dhe oferta juaj financiare.



7. Afati i dorëzimit të shërbimit pas njoftimit nga Banka:

Kërkuar nga Banka:

- Për listën e plote të inspektimeve elektrike afati i lëvrimit (përfshirë inspektimin dhe plotësimin e dokumentacionit) është 8 dite pune, pas konfirmimit nga Banka.
Ofruar nga ju: _____
- Për ashensorët afati i lëvrimit është dy dite pune.
Ofruar nga ju: _____

Shënim: Ditë pune konsiderohen E Hënë – e Premte, orari 8:30-17:00.

8. Oferta Juaj duhet përmbajë dokumentacionin e mëposhtëm:

A. Dokumentacion teknik dhe ligjor:

- Organi OMVK duhet të jetë i pajisur me licence aktive për:
 - Kategoria V – Vlerësim konformiteti në fushën elektrike,
 - Inspektim i instalimeve elektrike në ambientet e zakonshme,
 - Inspektim i impianteve mbrojtëse nga rrufeja,
 - Inspektim dhe certifikim I Ashensorëve
- Fotokopje e certifikatës së regjistrimit si person i tatueshëm nga organi përkatës dhe Kopje e ekstraktit të printuar nga e-albania të Regjistrimit tregtar nga QKR brenda muajit të fundit.
- CV e Kompanisë, organizimi
- Letër Reference për bashkëpunim relevant me institucione/kompani private dhe Lista e Klientëve për shërbime të njëjta apo të ngjashme me atë të kërkuar.

B. Formulari vigjilencës: Plotësoni, firmosni dhe vulosni formatin bashkëngjitur emailit.

9. Detajet e kontratës:

Kohëzgjatja: 3 (tre) vite. Draft kontrata është sipas Aneksit B. Jepni pranimin ose komentet tua për nenet e draft kontratës.

10. Për informacione të mëtejshme ju mund të kontaktoni me:

E-mail: procurement@tiranabank.al

11. Ju lutem konfirmoni në e-mailin e sipërhënuar marrjen e kësaj ftese dhe nëse ju pranoni të merrni pjesë në këtë procedurë prokurimi.

12. Në vëmendjen tuaj: Pagesat për kompaninë/te fituese për procesin e prokurimit do të bëhen nëpërmjet llogarisë në Bankën Tirana dhe në rast se nuk ka mundësi për të hapur një llogari në Bankën Tirana, komisionet e transferimit do t'i ngarkohen kompanisë.

Sinqerisht,
BANKA TIRANA



ANEKSI A – ÇMIMET DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

Nr.	Adresat e objekteve	Sipërfaqja e katit (m2)	Numri kateve	Sasia	Çmimi (TVSH përfshire)
A					
Certifikimi i instalimeve elektrike					
1	Dega Main MET+ Premium	363	1	1	
2	Zyrat Qendrore	1704 k1	4	1	
		1704 k2			
		525 k5			
		150 k-1			
3	Zogu i pare + Vault	307.8	1	1	
4	Autostrada	178	1	1	
5	Rr. Kavajes (GKAM)	312.2	2	1	
6	Parku	160	1	1	
7	Brryli	206.7	1	1	
8	Zogu Zi	141	1	1	
9	Kombinati	104.5	1	1	
10	Pazari I Ri	203.8	1	1	
11	Uzina Dinamo, Medrese	248	1	1	
12	Komuna Parisit	149	1	1	
13	Dega Astir	150	2	1	
		56.8			
14	Fier "Rr. Jakov Xoxa"	387	3	1	
15	Durresi Voloti	160	1	1	
16	Vlora "Lagjia Skele	200	1	1	
17	Elbasan "Lagjia Dylli Hasiri"	217	1	1	
18	Saranda "Rr. Skenderbeu"	254.65	1	1	
19	Ksamili	55	1	1	
20	Lushnja "Rr. I.S. Libohova"	178	2	1	
		19			
21	Lezhe "Lagjia Beslidhje Lezhe"	145	2	1	
22	Kamez Qender	165	1	1	
23	Kavaja Lagjia 2	339	1	1	
24	Librazhd tek ish-MAPO	140	1	1	
25	Berat "Lagjia 28 nentori)	112	1	1	
26	Bilisht Qender	154.84	1	1	
27	Permeti tek ish-Turizmi	148	1	1	
28	Vora Branch	66	1	1	
29	Lac Lagjia nr 3	163.68	1	1	
30	Durres Vollga	245	1	1	
31	Gjirokaster Branch	400	1	1	
32	Korce Branch	286	1	1	
33	Shkoder Branch	205	3	1	
34	Pogradeci Branch	159	1	1	
35	Dega Fresku	156.2	1	1	
36	Lion Park Office	805	1	1	
37	Dega Blloku	162.2	1	1	
38	Magazina Qendrore	Tirane	1	1	
39	Çdo ambient tjetër që mund të shtohet përgjatë periudhës së bashkëpunimit	Tirane dhe Deget jashtë Tirane	1	1	
B					
Inspektim/Certifikim I kabinave të transformimit TM/TU 20/0.5 KV					
40	Inspektim/Certifikim I kabines së transformimit TM/TU 20/0.5 KV	Shkoder 1/3 vjet	1	1	
41	Inspektim/Certifikim I kabines së transformimit TM/TU 20/0.5 KV	Korce 1/3 vjet	1	1	
C					
Certifikim Ashensori					
42	Certifikim periodik 6 mujori Ashensori			1	

Oferta juaj financiare duhet të jetë **ekzaktesisht** sipas tabelës së mësipërme.

Çmimet përfshijnë TVSH, transport dhe të gjithë taksat dhe shpenzimet e tjera.



ANEKSI B – DRAFT KONTRATA

Neni 1

BAZA LIGJORE

1.1 Baza ligjore e kësaj kontrate është ligji Nr. 7850, datë 29.07.1994 “Për Kodin Civil në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, konkretisht, Nenet 772-783 të tij.

Neni 2

OBJEKTI I KONTRATËS DHE LËVRIMI I PRODUKTEVE

- 2.1 Shoqëria kryen inspektimin e instalimeve, pajisjeve dhe impianteve elektrike ne fushat e mëposhtme, për të cilat është akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit dhe është miratuar nga Ministri i MIE:
- Certifikim i Instalimeve Elektrike ne ambientet ku zhvillohet aktiviteti bankar, Dege dhe Godina e Zyrave Qendrore (bashkelidhur lista e ambjenteve).
 - inspektim/Certifikim I kabinës se transformimit TM/TU 20/0.5 KV
 - Raport Inspektimi Periodik cdo 6 muaj Ashensorit
- 2.2 Banka dëshiron të kryejë sipas përcaktimeve ligjore në fuqi:
- inspektim te pajisjeve instalimeve, pajisjeve dhe impianteve elektrike 1 (nje) here ne vit
 - inspektim/Certifikim I kabinës se transformimit TM/TU 20/0.5 KV 1 (nje) here ne tre vjet
 - inspektimin te Ashensorit cdo 6 (gjashte) muaj
- 2.3 Objekt i kësaj kontrate është “Certifikimi i Instalimeve elektrike dhe sherbimeve te tjera te lidhura me te si dhe Siguria e Ashensoreve ne perdorim, ne ambjentet ku zhvillohet aktiviteti bankar në fushat e përmendura në nenin 2.1, në përputhje me VKM Nr. 245/2016, VKM 482/2020, VKM 483/2020, Rregulloret e Sigurimit Teknik në mëshitetje të Ligjit nr. 8734, datë 01.02.2001, “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike”, të ndryshuar dhe të Ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore” si dhe Kushtet Teknike te Projektit, Libri VI, KTP 15, 16, 17 nga ana e kompanise për pajisjet dhe instalimet elektrike dhe Ashensorit që disponon Subjekti, sipas Aneksit 1 bashkelidhur kësaj kontrate.
- 2.3 Palët bien dakord të realizojnë objektin e Kontratës sipas kushteve dhe termave të përcaktuara më poshtë.

Neni 3

ANEKSET

- 3.1 Aneksi 1 është pjesë përbërëse e kësaj kontrate.
- Aneksi 1 përfshin:
- Lista e sherbimeve per t’u kryer nga kompania me vlerat perkatese.
 - Lista e degeve te Tirana Bank ku do te kryhet inspektimi dhe certifikimi.

Neni 4

KOHËZGJATJA E KONTRATËS

- 4.1 Kjo kontratë është e vlefshme per nje periudhe 3 (tre) vjeçare
- 4.2 Kjo kontrate i shtrin efektet qe nga **data xx.xx.2026** dhe përfundon me dorëzimin e raporteve, protokolleve të tokëzimit, dëshmime, regjistrave dhe certifikimeve, nëpërmjet procesverbalit të dorëzimit, si dhe kryerjes së pagesës nga Banka.

Neni 5

ÇMIMET DHE AFATI I LEVRIMIT

- 5.1 Çmimi i produkteve objekt të kësaj Kontrate jepet në Aneksin 1, ku përfshihen TVSH, transport dhe të gjitha taksat dhe tatimet e detyrueshëm për t’u paguar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 5.2. Palët bien dakord që cmimet e përcaktuara në Aneksin 1 bashkelidhur do te jene te pandryshuara gjate gjithe kohezgjatjes se kontrates.
- 5.3 Pagesa do te kryhet ne numrin e llogarise prane Tirana Bank me numer ne _____: xxxxxxxx, brenda 30 ditesh nga përfundimi i inspektimit dhe certifikimet dhe prerja e fatures. Faturimi behet pas perfundimit te procesit te inspektimit, ne momentin e dorezimit te dokumentacionit.
- 5.4 Afatin e levrimit te certifikimit pas njoftimit nga Banka:
- Per listen e plote te inspektimeve elektrike afati I levrimit (pershire inspektimin dhe plotesimin e

dokumentacionit) është ____ dite pune, pas konfirmimit nga Banka.

- Per ashensorët varet nga vendodhjet. Nëse janë në një adresë afati i levrimit është _____ dite pune. Ditët e punës konsiderohen E Hënë – e Premte, orari 8:30-17:00.

Neni 6

DETYRIME DHE TË DREJTA TË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË

- 6.1 Shoqëria duhet të kryejë dhe të përmbushë shërbimet dhe detyrimet e saj në përputhje me kërkesat e KTP perkatëse dhe legjislacionit në fuqi dhe sipas kalendarit kohor të dakortësuar midis palëve, sipas Aneksit 1 bashkëlidhur kësaj kontrate.
- 6.2 Shoqëria duhet të kryejë inspektimin e pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike dhe inspektimin 6 mujor të ashensorit dhe plotësimin e fleteve të punës dhe certifikatave të inspektimit.
- 6.3 Për impiantet, pajisjet, instalimet elektrike dhe ashensorit që nga inspektimi nuk rezultojnë të rregullta sipas kushteve teknike përkatëse nuk lëshohet Çertifikatë Inspektimi. Në këtë rast kompania i lëshon subjektit një raport inspektimi për marrjen e masave për përmbushjen e parregullsive.
- 6.4 Shoqëria nuk mban përgjegjësi në rastet e shkeljeve që dalin jashtë kuadrit të Çertifikatës së Inspektimit dhe që bien në kundërshtim me legjislacionin përkatës në fuqi.
- 6.5 Mosrespektimi i legjislacionit në fuqi për pajisjet, impiantet, instalimet elektrike dhe inspektimet 6 mujore të ashensorit, nga ana e Subjektit sjell në mënyrë automatike anulimin e Çertifikatës së Inspektimit të lëshuar për këtë pajisje, instalim apo impiant elektrik nga ana e Shoqërisë.
- 6.6 Shoqëria është e detyruar të ofrojë shërbimin e tij në përputhje me objektin e kontratës në kushte optimale dhe të një standardi profesional
- 6.7 Shoqëria duhet të marrë në konsideratë të gjitha kërkesat, orientimet, udhëzimet e subjektit dhe t'i zbatojë ato me rigorozitet, për sa ato janë në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate dhe legjislacionin në fuqi
- 6.8 Shoqëria nuk mban përgjegjësi për pasojat që mund t'i vijnë subjektit nga fshehja e informacionit, pavërtetësia e dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti, moslajmërimit në kohë apo nga vonesat për konfirmimet/informacionet e kërkuara
- 6.9 Me nënshkrimin e kësaj kontrate t'i paraqese subjektit listen e plote të personelit që do të punojë në objekt me të dhëna të plota personale dhe profesionale.
- 6.10 Të marrë të gjitha masat për respektimin e rregullave të sigurimit teknik. Të krijojë kushte normale pune duke marrë masa për sigurimin e vendit të punës, veshjet dhe pajisjet mbrojtëse, si dhe instruktimin e punonjësve për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së shëndetit në punë.

Neni 7

DETYRIME DHE TË DREJTA TË PËRGJITHSHME TË BANKËS

- 7.1 Banka duhet të përgatisë paraprakisht kushtet për kryerjen e inspektimit në mënyrë korrekte, sipas listës bashkëlidhur, në mënyrë që shoqëria të kryejë kontrollin e tyre sipas legjislacionit dhe standardeve në fuqi.
- 7.2 Banka kryen pagesën sipas përcaktimeve të kësaj kontrate.
- 7.3 Secila palë do të sigurojë vazhdimësinë e marrëdhënies ndërmjet tyre, duke u bazuar në parimin e korrektesës në përmbushjen e detyrimeve respektive.
- 7.4 Të dyja palët pjesëmarrëse në këtë Kontratë garantojnë se nuk do të ndërmarrin apo kryejnë asnjë veprim, mos-veprim i cili me natyrën e tij do të ndikonte në prishjen e imazhit të secilës palë.
- 7.5 Banka ka detyrimin të paguajë Çmimin në përputhje me parashikimet e Kontratës.
- 7.6 Banka ka detyrimin të sigurojë informacionin e kërkuar nga Shoqëria në kohë.

Neni 8

KONFIDENCIALITETI

- 8.1 Shoqëria dhe punonjësit e saj janë kategorikisht të ndaluar të kenë akses në të dhënat personale të të tretëve të mbledhura nga Banka gjatë aktivitetit të saj.
- 8.2 Palët janë të detyruara të ruajnë plotësisht konfidencialitetin dhe të mos u bëjnë të njohur të tretëve asnjë informacion që ato mund të marrin, si gjatë zbatimit të kësaj kontrate ashtu edhe pas përfundimit të saj.
- 8.3 Palët bien dakord që konsiderohen të fshehta dhe sekrete informacionet me gojë ose me shkrim, të dhënat, metodat, teknikat ose procedurat që ndjek Banka për planifikimin, zhvillimin dhe ofrimin e produkteve ose shërbimeve të saj si dhe çdo informacion që ka të bëjë me klientelën, veprimtarinë afariste dhe personelit që ka Banka. "Shoqëria" si dhe punonjësit e saj, janë të detyruar për mbajtjen e fshehtësisë së plotë për informacionet dhe të dhënat që bëhen të njohura për ta nëpërmjet kësaj kontrate, si gjatë periudhës së kësaj



kontrate ashtu edhe pas përfundimit të saj (pa kufizim kohor), duke pasur përgjegjësi penale në bazë të Kodit Penal si dhe përgjegjësi për kompensimin e çdo dëmi që mund ti shkaktohet Bankës për arsye të shkeljes së detyrimit të lartpërmendur.

8.4 Të gjithë punonjësit e “Shoqërisë” nënshkruajnë “Deklaratën e Konfidencialitetit” për ruajtjen e fshehtësisë së informacionit, para fillimit të punës. Çdo punonjës është i ndërgjegjshëm për pasojat që ka në rast të shkeljes së “Deklaratës së Konfidencialitetit”, si dhe të kërkesave të ligjit nr. 9987, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe Standardit ISO/IEC 17020:2012 paragrafi 4.1 dhe 4.2.

“Shoqëria” si dhe punonjësit e saj, nuk duhet të përdori informacione apo të dhëna që bëhen të njohura për ta nëpërmjet kësaj kontrate, lidhur me veprimtarinë e Bankës apo Klientëve të saj, për qëllimet e tij ose për qëllime të tjera, të shpërndaje ose të bëjë të njohur (transmetojë) informacion tek persona, shoqëri, biznese ose organizata të tjera.

8.5 “Shoqëria” duhet të njoftojë “Bankën” në rast cënimi të të dhënave personale të mbledhura nga kjo e fundit.

8.6 “Shoqëria” duhet të njoftojë Bankën menjëherë dhe pa vonesë, për çdo dëm, dëmtim ose për çdo ngjarje tjetër të jashtëzakonshme gjatë ushtrimit të shërbimit.

8.7 “Shoqëria” merr përsipër të mos përdorë dhe të mos ia transmetojë personave të paautorizuar të dhënat apo informacionet e grumbulluara nga subjekti gjatë kryerjes së aktivitetit të inspektimit, përveç se në rastet kur është e parashikuar me ligj dhe kërkohet nga organet përkatëse shtetërore.

Neni 9

NJOFTIMET

9.1 Njoftimet/komunikimet ndërmjet palëve kryhen më shkrim në adresat respektive të tyre të referuara në hyrje të kontratës. Çdo njoftim/komunikim ndërmjet palëve nëpërmjet postës elektronike, konsiderohet i vlefshëm. Adresat e palëve dhe personat e kontaktit:

Për Shoqërinë: XXXX XXXXXX:

Për Banken: XXXXXX XXXXXX:

Neni 10

SANKSIONET

10.1 Në rast se “Shoqëria” nuk e kryen ose vonon shërbimin objekt i kësaj kontrate pa arsye, atëherë ai është i detyruar t’i paguajë “Bankës” për çdo ditë vonesë një penaltitet sipas kamatës ligjore në fuqi, në përputhje me Ligjin 48/2014 date 24.04.2014.

10.2 “Banka” i mban vlerën e penaltitetit Shoqërisë nga pagesa, duke dhënë me shkrim arsyet dhe shumën totale të penaltitetit.

10.3 Në rast se Banka vonon pagesën pa arsye, Banka do të paguajë penaltitet sipas kamatës ligjore sipas ligjit të përcaktuar në pikën 10.1 më sipër. Nëse nuk paguan, Shitësi nuk do të kryejë shërbimin e radhës dhe do të kërkojë zgjidhjen e Kontratës dhe dëmshpërblimet përkatëse.

10.4 Këto sanksione nuk do të aplikohen në rastet e Forcës Madhore sipas dakordësisë së Palëve.

Neni 11

KLAUZOLA KUNDER RYSHFETIT DHE KORRUPSIONIT

11.1 Shoqëria angazhohet se nuk do të marre, nuk do të ofroje, premtojë ose do të japë ndonjë përfitim financiar ose të ndonjë lloji tjetër, që nuk është i detyrueshëm sipas praktikave me të mira tregtare apo kushteve kontraktuale, drejtperdrejt ose terthorazi për ndonjë person ose subjekt të lidhur apo jo me Bankën, në këmbim që ata të veprojnë ose të mos veprojnë në kundërshtim me permbushjen e detyrave të tyre për t’i mundësuar Shoqërisë lidhjen dhe/ ose permbushjen e kësaj Kontrate.”

Neni 12

ZGJIDHJA E KONTRATËS

12.1 Secila palë mund ta zgjidhë në mënyrë të njëanshme kontratën, në qoftë se pala tjetër shkakton shkelje thelbësore të saj që janë:

12.1 a. “Banka” konstaton se:

- “Shoqëria” nuk respekton afatet, specifikimet dhe cilësinë e përcaktuar në aneksin 1.

- “Shoqëria” vonon shërbimin, tej afateve të përcaktuara në kontratë.



- "Shoqëria" nuk është në gjendje të permbushë në rregull, detyrimet kontraktore.

12.1 b. Shoqëria konstaton se:

- "Banka" nuk kryen pagesat sipas faturave dhe cmimeve sipas Aneksit 1.

- "Banka" vonon pagesat, tej afateve të përcaktuara në kontratë.

- "Banka" nuk është në gjendje të permbushë në rregull, detyrimet kontraktore.

12.2 Kontrata do të quhet e zgjidhur për shkaqet e përmendura në paragrafin 12.1 mësipër, nëse pala që ka shkelur kushtet e kontratës nuk i përmbush plotësisht ato brenda 30 ditëve kalendarike nga dita që ka marre njoftimin e palës tjetër lidhur me konstatimin e këtyre shkeljeve dhe detyrimin e saj (palës që ka shkelur kontratën) për të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për ndreqjen e tyre brenda afatit 30 ditor të njoftimit.

12.3 "Palët" mund të kërkojnë në çdo kohë, zgjidhjen e kësaj kontrate, duke e lajmëruar me shkrim palën tjetër 60 ditë kalendarike më përpara.

Neni 13

DËMTIMET

13.1 Shoqëria" është përgjegjëse në çdo dëm që mund t'i shkaktohet Bankës nga veprimet keqdashëse që mund të kryehen nga punonjësit e saj gjatë kohës së ekzekutimit të kësaj kontrate ose në marrëveshjet shtesë që mund të hartohen në të ardhmen, dhe është i detyruar të dëmshpërblejë "Bankën".

13.2 I njëjti nen si më sipër do të aplikohet dhe në favor të Shoqërisë kundrejt Bankës.

Neni 14

NDRYSHIMET DHE SHTESAT E KONTRATËS

14.1 Ndryshimet ose shtesat e kësaj Kontrate janë të vlefshme vetëm në rast se bëhen me shkrim dhe nënshkruhen nga të dyja palët.

Neni 15

FORCAT MADHORE

15.1 Forcat madhore nënkuptojnë embargo, revolucion, grevë, luftë (të deklaruar ose jo), aksione apo kërcënime nga terroristët ose grupet guerrile, zjarri, përmytjet, tërmetet

15.2 Palët bien dakort se asnjë palë nuk do të jetë përgjegjëse në mospërmbushje të detyrimeve ndaj palës tjetër nëse këto vijnë si rezultat i Forcave madhore. Ky nen do të zbatohet vetëm nëse këto Forca Madhore ndodhin pas firmosjes së kësaj kontrate.

15.3 Palët janë të detyruara të njoftojnë me shkrim njëra tjetrën brenda 14 ditëve duke filluar nga dita e ngjarjes, në rast se ndodh ndonjë Forcë Madhore. Palët janë të detyruara të njoftojnë në të njëjtën mënyrë kur Forca Madhore përfundon.

15.4 Nëse përmbushja e detyrimeve kontraktuale do të vonohet 2-3 muaj për shkak të Forcave Madhore, palët duhet të bien dakort me shkrim për kushtet e reja të përmbushjes së kontratës ose për kushtet e anulimit të kontratës.

Neni 16

LIGJSHMËRIA DHE ZGJIDHJA E KONFLIKTEVE

16.1 Kjo kontratë i nënshtrohet Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë" në vaçanti dhe legjislacionit shqiptar në fuqi në përgjithësi.

16.2 Çdo mosmarrëveshje midis tyre, palët angazhohen se do ta zgjidhin me mirëkuptim, në rast se kjo nuk do të arrihet, atëherë kompetente për zgjidhjen e konfliktit midis tyre do të jetë Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Neni 17

TË PËRGJITHSHME

17.1 Kjo kontratë hartohet në dy kopje dhe hyn në fuqi pasi firmoset nga palët.

17.2 Secila palë merr një kopje.

Neni 18

HYRJA NË FUQI

18.1 Kjo kontratë i shtrin efektet nga data xx.xx.2026 pavaresisht dates se nenshkrimit.

